

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
TË AUTORITETIT KOMBËTAR TË USHQIMIT
VITI 2026**

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Natyra e kërimit	Objekti i kërkesës (përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Përgjigje (përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi)	Data e kthimit të përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (përgjigjja jepet e plotë / e kufizuar / e deleguar)	Tarifa
100.	01.07.2026	Kërkesë për informacion mbi kryerjen e shërbimeve laboratorike	Subjekti kërkon informacion në lidhje me analizimin e një mostre orizi pa etiketë, si dhe mielli pa etiketë, me qëllim verifikimin e përmbajtjes (ose jo) të glutenit, sipas metodës ELISA.	Në zbatim të VKM-së nr.708, datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”; Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, miratuar me Urdhër nr.279, datë 23.06.2022 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; si dhe Urdhrit nr.7, datë 10.01.2025 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, aktualisht, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka në strukturën e tij, 7 (shtatë) Sektorë të Shërbimeve Laboratorike nën varësi të Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (si dhe 12 Drejtori Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, përgjegjëse për veprimtarinë inspektuese). Në kuadër të kontrollit zyrtar, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit analizon duke u bazuar në një Plan Vjetor Kombëtar me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për	02.07.2026	e plotë	nuk ka

			<i>kafshë, mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore, si dhe Planit të Marrjes së Mostrave në Pikat e Inspektimit Kufitar, për monitorime apo raste emergjente. Mostrat përkatëse merren nga trupa inspektuese e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe dërgohen për analizim në Laboratorët të miratuar të kontrollit zyrtar, Laboratorët rajonalë të institucionit, si dhe në Laboratorin e referencës “ISUV”.</i> <i>Duke qenë se bëhet fjalë për produkte ushqimore të pa identifikueshme ligjërisht, produkti nuk mund të klasifikohet në kategorinë e një produkti ushqimor për mungesë të identifikimit, si dhe kërkesave të elementëve bazë të kërkuar nga legjislacionit ushqimor (kryesisht ligjit të posaçëm nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar) dhe ligjit nr.99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, apo standardet shqiptare në fuqi).</i> Për sa më sipër parashtruar, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk mund të plotësojë kërkesën e adresuar nga ana subjektit. <i>Lidhur me kërkesën për adresim laboratorik,</i> informojmë se lista e laboratorëve të akredituar në Shqipëri dhe shërbimet e ofruara prej tyre, gjenden të publikuara në faqen zyrtare (web) të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit (DPA) www.dpa.gov.al ku disponohet çdo informacion i detajuar.			
--	--	--	--	--	--	--

101.	02.07.2026	Kërkesë për informacion	Në referim të njoftimit ‘<i>ALERT</i>’ të datës 25.06.2026, për: “<i>Prani e acidit hidrocianik (HCN) mbi vlerën e lejuar në bajame me origjinë nga Spanja</i>”, kërkohet informacioni i mëposhtëm: 1. Sa është sasia totale (në kilogramë ose ton) e produktit bajame “Blanched Almond Extra Fine” (LOT: LO12200001, skadenca 22/10/2026) që ka hyrë në Republikën e Shqipërisë? 2. Të specifikohet sasia e importuar për secilin nga operatorët e mëposhtëm: • “A*** S*** D***”; • “N***”; dhe • “A*** G***”. 3. A i është nënshtruar kjo ngarkesë, kontrolleve apo analizave laboratorike për mbetje toksike nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në momentin e hyrjes në kufi? 4. Sa është sasia e këtij lot-i që përfundoi në treg dhe është blerë nga konsumatorët përpara se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të nxirrte njoftimin e bllokimit më datë 25.06.2026?	Rezulton se sasia totale e këtij produkti, i cili ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, është 1200 kg, importuar nga secili prej 3 (tre) operatorëve të listuar, si më poshtë: • Subjekti importues “A*** S*** D***” ka importuar 300 kg; • Subjekti importues “N***” ka importuar 800 kg; dhe • Subjekti importues “A*** G***” ka importuar 100 kg. Sjellim në vëmendje se njoftimi për moskonformitetin e këtyre produkteve ka ardhur nga sistemi ‘<i>RASFF</i>’. Produkti në fjalë “<i>Bajame Pluhur</i>” është importuar në Shqipëri në periudhën nga Dhjetor 2025 deri në Shkurt 2026, ku i është nënshtruar kontrollit fizik dhe dokumentar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK). Produkti ka qenë i shoqëruar me dokumentacion të rregullt nga vendi i origjinës (BE), me certifikatë shëndetësore dhe raport analize të rregullt. Referuar legjislacionit në fuqi, të gjitha dërgesat që importohen në Republikën e Shqipërisë duhet të kenë kaluar kontrollin e dokumentacionit, të identitetit dhe atë fizik, nën përgjegjësinë e inspektorëve të PIK, përpara se të lirohet për qarkullim të lirë. Analizimi në Kufi i produkteve ushqimore kryhet në zbatim të Planit Vjetor me bazë risku, miratuar nga Ministri, në të cilin nuk ka të përcaktuar analizimin e treguesit acidi hidrocianik (HCN).	10.07.2026	e plotë	nuk ka
------	------------	-------------------------	---	--	------------	---------	--------

			5. Në cilat qytete është shpërndarë ky produkt nga tre operatorët e mësipërm? 6. Sa është sasia e bllokuar / bllokuar në magazinat e tyre dhe sa është sasia e kthyer deri më tani nga konsumatorët pas thirrjes publike? 7. A ka nisur Autoriteti Kombëtar i Ushqimit procedurë administrative apo penalizim ndaj importuesve për mos-sinjalizim në kohë, apo ndaj pikës kufitare që lejoi hyrjen e rrezikut?	<i>Në përgjigje të pyetjes së katërt</i>, sasia totale e këtij loti e cila është treguar në Republikën e Shqipërisë para ardhjes së njoftimit nga sistemi ‘RASFF’, është 1158 kg. <i>Në përgjigje të pyetjes së pestë</i>, sasia më e madhe e këtij produkti është shpërndarë në Tiranë dhe në sasi të vogla në qytete si: Shkodër, Vlorë, Durrës, Fier. <i>Në përgjigje të pyetjes së gjashtë</i>, sasia totale e bllokuar në subjekt është 42 kg nga të cilat 12 kg janë të kthyer tregu. <i>Së fundmi</i>, informojmë se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për sasi të konstatuara gjende në subjekt, ka marrë masën urgjente të bllokimit të produktit me qëllim kalimin e tij për asgjësim.			
102.	02.07.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti kërkon informacion lidhur me pajisjen me Akt-Miratimi Higjieno-Sanitar pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Konkretisht, për kompani të cilat ushtrojnë aktivitetin tregtar në: prodhimin, përpunimin, ruajtjen, transportin dhe shpërndarjen e produkteve dhe lëndëve ushqimore si dhe ofron shërbime në fushën e kulinarisë, gastronomisë, restorantit dhe kateringut — për t’u pajisur me Akt-Miratimi Higjieno-Sanitar.	Në zbatim të ligjit nr.54/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7643, datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar” plotësimi i kushteve dhe kërkesave ligjore higjieno-sanitare ndaj operatorëve të biznesit të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e ushqimit, i është atribuuar si kompetencë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Si pasojë e ndryshimeve të sipërcituara, theksojmë se verifikimi i zbatimit të kërkesave ligjore referuar kushteve higjieno-sanitare tashmë ezaurohet nga kontrollet zyrtare inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.	07.07.2026	e plotë	nuk ka

				Kërkesat ligjore në fuqi të cilat verifikohen në kuadër të procesit inspektues nga Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në çdo qark të vendit, janë ato të parashikuara në ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” (i ndryshuar); Udhëzimin nr.22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor”; si dhe akte të tjera nënligjore referuar natyrës së aktivitetit specifik të subjektit. Për sa më sipër, me qëllim pajisjen me leje higjieno-sanitare, subjekti duhet të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Rajonale përkatëse të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në qarkun ku ushtron aktivitet. <i>Kontrolli nga ana e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, ofrohet pa tarifë.</i>			
102.1.	08.07.2026	Vijim komunikimi (kërkesë për informacion shtesë)	Në vijim të komunikimit (tabela 102), subjekti kërkon informacion shtesë lidhur me adresën e Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë dhe nëse bashkëlidhur kërkesës, nevojitet dokumentacion bashkëlidhur.	Adresa e Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë (DRAKU Tiranë), është: <i>Rruga "Hamdi Pepa", Selitë, Tiranë.</i> Po kështu, sqarojmë se bashkëlidhur kërkesës, <u>nuk</u> nevojitet dokumentacion shtesë.	08.07.2026	e plotë	nuk ka

103.	08.07.2026	Kërkesë për punësim	Subjekti shpreh interesin për punësim pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, pasi ka përfunduar studimet <i>Bachelor</i> në <i>Teknologji Ushqimore</i> .	Vendet vakante të institucionit publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në web-in: <u>Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (www.aku.gov.al)</u> , seksioni 'Rreth Nesh' > 'Mundësi punësimi' > 'Shpallje për vende të lira pune' dhe/ose në faqen zyrtare të Inspektoratit të Përgjithshëm (për pozicionet me funksione inspektuese), në web-in: <u>Inspektorati i Përgjithshëm</u> .	08.07.2026	e plotë	nuk ka
104.	11.07.2026	Kërkesë për punësim	Subjekti shpreh interesin për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Vlorë, pasi ka përfunduar studimet <i>Bachelor</i> në <i>Biologji të Përgjithshme</i> .	Çdo shpallje e pozicioneve vakante përmban informacionin e duhur dhe të plotë në lidhje me pozicionin e lirë, sektorin dhe drejtorinë përkatëse, kategorinë e pagës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta mbi arsimin, përvojën, etj., si dhe rregullat mbi afatin, mënyrën e dorëzimit të aplikimit dhe dokumentacionit të kërkuar.	11.07.2026	e plotë	nuk ka
105.	22.07.2026	Kërkesë për punësim	Subjekti shpreh interesin për punësim pranë Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, pasi ka përfunduar studimet <i>Bachelor</i> në <i>Teknologji Ushqimore</i> .		22.07.2026	e plotë	nuk ka
106.	22.07.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti kërkon informacion lidhur me <i>hapjen e një biznesi për import-eksport të suplementeve ushqyese, vitaminave, çamçakëz me vitamina</i> , konkretisht: - Çfarë dokumentacioni nevojitet nga prodhuesi, i cili është vend anëtar i Bashkimit Evropian (BE) dhe a duhet të regjistrohen këto suplemente pranë AKBPM (Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore)?	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për inspektimin në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) në fushën e sigurisë ushqimore, ushtron veprimtarinë e tij duke u mbështetur në ligjin nr.9863, datë 28.01.2008 “ <i>Për Ushqimin</i> ” (i ndryshuar) dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Këto akte nënligjore përcaktojnë parimet, procedurat dhe mekanizmat mbi bazën e të cilave realizohen kontrollet zyrtare në Kufi, me qëllim garantimin e shëndetit publik dhe mbrojtjen e konsumatorit. Kështu, për kryerjen e importit në Republikën e Shqipërisë, zbatohen kërkesat e Urdhrit nr.374, datë 31.08.2017 “ <i>Për një ndryshim në Urdhrin nr.72, datë 15.03.2011 “Për Miratimin e Akt –</i>	28.07.2026	e plotë	nuk ka

			<i>Kontrollit “Mbi Inspektimin e produkteve ushqimore me origjinë jo shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për zhdoganimin e tyre” dhe Akt-“Marrje Mostre” për produktet me origjinë jo shtazore të cilat importohen në Republikën e Shqipërisë. Të tilla produkte, shoqërohen me dokumentacionin si më poshtë:</i> • Certifikatë e vendit të origjinës, e cila tregon origjinën e produktit dhe lëshohet nga Dhoma e Tregtisë e vendit nga eksportohet produkti; • Raport-Analizë për produktin; • Faturë. Produktet <i>suplemente ushqimore</i> nuk kanë si kriter regjistrimin e tyre për t’u importuar në Republikën e Shqipërisë. Për këto produkte kryhet kontrolli zyrtar në PIK nga ana e trupës inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe vetëm kur ngarkesa plotëson kërkesat ligjore, lejohet të futet në territorin e Shqipërisë. Ndër aktet nënligjore lidhur me përbërësit që nevojitet të përmbajnë suplementet për import në Republikën e Shqipërisë, rendisim: • Urdhër nr.216, datë 23.05.2008 “<i>Për miratimin e Rregullores “Për Ushqimet shtesë”</i>”, ndryshuar me Urdhër nr.565, datë 19.12.2014 “<i>Për një ndryshim në Urdhrin nr.216, datë 23.05.2008</i>”; • Urdhër nr.374, datë 31.08.2017; dhe • Urdhër nr.146, datë 29.04.2009 “<i>Për miratimin e Rregullores “Për ushqimet për përdorim në dietat me energji të kufizuar për ulje në peshë”</i>”.			
--	--	--	--	--	--	--

107.	22.07.2026	Kërkesë për informacion	Në vijim të njoftimit të kategorisë “Njoftim informues për vëmendje” nga sistemi ‘RASFF’, ku Shqipëria është etiketuar për ndjekje lidhur me produktet me risk serioz për shëndetin e njeriut me origjinë nga Korea e Jugut (Lloji: Produkte të pjekura / Kek orizi / Njoki), konkretisht: “YOPOKKI gnocchi di riso cup (njoki) – LOT: 181226 (Skadenca: 18/12/2026) dhe LOT: 260126 (Skadenca: 18/12/2026); Yopokki ricecake cup kimchi (kek orizi) – LOT: 260126 (Skadenca: 13/12/2026), subjekti kërkon informacion sa më poshtë vijon: 1. Sa është sasia totale e importuar (në kg/pako) e këtyre dy produkteve (për lotet specifike) që ka hyrë në Shqipëri? 2. Sa është sasia e bllokuar? 3. Sa është sasia e shitur tek konsumatori fundor? 4. Në cilat qytete është shpërndarë produkti? 5. A janë marrë masa administrative ndaj operatorit importues? 6. Nëse po, çfarë masash janë marrë? 7. Vënien në dispozicion të foto të produkteve.	Në përgjigje të pyetjes së parë, rezulton se produkti është importuar në Republikën e Shqipërisë me 2 (dy) praktika doganore, konkretisht: • Në praktikën e datës 28.01.2026, produkti <i>Kek Yopokki gnocchi di riso cup gusto formaggio</i> me Lot: 181226 dhe me datë skadence 18.12.2028, është importuar në sasinë 7.2 kg; • Në praktikën e datës 19.03.2026, produkti <i>Kek Yopokki gnocchi di riso cup gusto</i> me Lot: 260126 dhe me datë skadence 18.12.2028, është importuar në sasinë 10.8 kg ndërsa produkti <i>Kek Yopokki ricecake cup kimchi</i> me Lot: 260126 dhe me datë skadence 13.12.2029, është importuar në sasinë 3.45kg. Shënim: Sqarojmë se në njoftimin e ardhur nga sistemi RASFF, data e skadencës së produkteve është si më poshtë: • Produkti <i>Kek Yopokki gnocchi di riso cup gusto formaggio</i> me Lot: 181226, me datë skadence 18.12.2026; • Produkti <i>Kek Yopokki gnocchi di riso cup gusto</i> me Lot: 260126, me datë skadence 18.12.2026; dhe • Produkti <i>Kek Yopokki ricecake cup kimchi</i> me Lot: 260126, me datë skadence 13.12.2026. Megjithatë, nga verifikimi i praktikave doganore si dhe nga verifikimi i dokumentacionit pranë subjektit, rezulton se bëhet fjalë për të njejtat produkte me të njejtat specifikime për sa i takon emërtimit, numrit të lot-it, por me data skadence të ndryshme (sipas citimeve më lart).	28.07.2026	e plotë	nuk ka
------	------------	-------------------------	---	---	------------	---------	--------

			<i>Në përgjigje të pyetjes së dytë</i>, nga verifikimet e kryera në terren, produkti i mësipërm nuk u konstatua gjendje. Ndërsa, nga verifikimi i sistemit të gjurmueshmërisë, rezultoi se ky i fundit nuk ishte funksional. Për rrjedhojë, ndaj subjektit u mor masa administrative “Gjobë” për mungesë të sistemit të gjurmueshmërisë si dhe për përgjegjësitë e operatorit të biznesit. <i>Në përgjigje të pyetjes së tretë</i>, rezulton se sasia totale e importuar sipas lotëve të sipërcituar, është 21.45 kg e për rrjedhojë, sasia e shitur është 21.45 kg. <i>Në përgjigje të pyetjeve katër, pesë & gjashtë</i>, duke qenë se nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se sistemi i gjurmueshmërisë nuk ishte funksional, nuk është i mundur identifikimi i qyteteve ku është shpërndarë produkti. Kështu, ndaj subjektit tregtar janë marrë 2 (dy) masa administrative “Gjobë”, për mungesë të sistemit të gjurmueshmërisë dhe përgjegjësisë së operatorit të biznesit. <i>Lidhur me kërkimin e subjektit të interesuar për vënien në dispozicion të fotove të produkteve</i>, informojmë se Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nuk disponon foto të produktit.			
--	--	--	---	--	--	--

108.	27.07.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me disa njoftime që kanë qarkulluar për produktin “MINESTRONE 16 Verdure”, perime të ngrira me peshë 750 gram, me numër loti L03DK dhe afat skadence 30 qershor 2028, i importuar në Shqipëri nga kompania “PR***** T****”. Sipas raportimeve, në një paketim të këtij produkti është konstatuar prania e një trupi të huaj, potencialisht të rrezikshëm. Gjatë verifikimeve kemi konstatuar se rasti i bërë publik nga autoritetet italiane dhe nga Sistemi European i Alarmit të Shpejtë për Ushqimin dhe Ushqimin e Kafshëve (RASFF) në muajin janar 2026 lidhet me një produkt tjetër, konkretisht me lotin L25265, të prodhuar nga Agrifood Abruzzo Srl, i cili është tërhequr nga tregu për shkak të pranisë së mundshme të substancave të dëmshme, konkretisht: 1. A është njoftuar Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për tërheqjen e lotit L25265 dhe a ka ndërmarrë institucioni masa për informimin e konsumatorëve e	Rezulton se më datë 22.06.2026, sistemi “RASFF” ka publikuar njoftimin me nr.849042 dhe nr.reference 2026.5440 të kategorisë: serioz, me temë: “Trup i huaj në supë me perime të ngrira”, në të cilin Shqipëria është etiketuar për ndjekje, e konkretisht: Lloji i operatorit: Importues Emri: “PR***** T****” SHPK Adresa: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Tiranë Të dhëna: Dokumenti nr.5226031625, datë 12.05.2026 Lloji i operatorit: Importues Emri: “PR***** T****” SHPK Adresa: Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë Të dhëna: Dokumenti nr.5226031626, datë 12.05.2026 Emri i produktit: MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë) me LOT L03DK dhe datë skadence 30.06.2028. Duke u bazuar në këtë njoftim, më datë 22.06.2026 dhe 23.06.2026, nga ana e trupës inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është ushtruar inspektim pranë subjektit “PR***** T****” SHPK me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Tiranë, ku u konstatua sa më poshtë vijon. Subjekti ka importuar produktin e sipërcituar: MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30.06.2028, importuar më datë 14.05.2026 në sasinë 14 copë x 0.750 kg = 10.5 kg.	03.08.2026	e plotë	nuk ka
------	------------	-------------------------	--	--	------------	---------	--------

		verifikimin e pranisë së këtij produkti në tregun shqiptar? 2. A ka kryer Autoriteti Kombëtar i Ushqimit verifikime për produktin “MINESTRONE 16 Verdure”, me numër loti L03DK dhe datë skadence 30 Qershor 2028? Nëse po, cilat janë rezultatet e deritanishme? 3. A ka elemente që tregojnë se ky produkt paraqet rrezik për shëndetin e konsumatorëve? 4. Çfarë masash do të ndërmarë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në rast se konfirmohet se produkti me lotin L03DK paraqet rrezik ose vijon të tregtohet në rrjetet e shitjes? 5. A janë kryer kontrole pranë subjektit importues “PR***** T*****” dhe në pikat e tregtimit?	Gjendje: Në subjekt nuk u konstatua gjendje asnjë sasi e produktit MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30.06.2028. Shitja e produktit: Rezulton se produkti është shitur tek konsumatori i fundit në sasinë 14 copë x 0.750 kg = 10.5 kg. Në këto kushte, pranë subjektit është vendosur njoftimi për konsumatorët: <i>“Kush e ka blerë produktin MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30/06/2028, ta kthejë pranë supermarketit”</i>. Më datë 23.06.2026, nga ana e trupës inspektuese të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit është ushtruar inspektim pranë subjektit “PR***** T*****” SHPK me adresë: Rruga e Kavajës, Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë, ku u konstatua sa më poshtë vijon. Subjekti ka importuar produktin e sipërcituar: MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30.06.2028, importuar më datë 14.05.2026 në sasinë 14 copë x 0.750 kg = 10.5 kg. Gjendje: Në subjekt nuk u konstatua gjendje asnjë sasi e produktit MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30.06.2028. Shitja e produktit: Rezulton se produkti është shitur tek konsumatori i fundit në sasinë 14 copë x 0.750 kg = 10.5 kg.			
--	--	--	--	--	--	--

			Në këto kushte, pranë subjektit është vendosur njoftimi për konsumatorët: <i>“Kush e ka blerë produktin MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30.06.2028 dhe e ka në gjendje, ta kthejë pranë supermarketit”</i>. Për sa më sipër parashtruar, rezulton se në të dy subjektet tregtare “PR***** T****” SHPK është importuar produkti i sipërcituar: “MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30.06.2028”, importuar më datë 14.05.2026 në sasinë 28 copë x 0.750 kg = <u>21 kg</u>. Gjendje: Në subjekt nuk u konstatua gjendje asnjë sasi e produktit MINESTRONE 16 VERD. S./B. G750 (supë e ngrirë), LOT L03DK; datë skadence: 30.06.2028. Shitja e produktit: Rezulton se produkti është shitur tek konsumatori i fundit në sasinë 28 copë x 0.750 kg = 21 kg. Lidhur me masat e marra ndaj subjektit, në përputhje dhe në zbatim të nenit 44, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.99/2024 <i>“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”</i>, për shkeljet e kërkesave ligjore që përbëjnë kundërvajtje administrative, subjekti i inspektimit dënohet me masë <i>“Paralajmërim”</i> në inspektimin e parë, si dhe i lihet për detyrë të njoftojë në mënyrë të vazhdueshme konsumatorin për produktin e blerë si dhe të njoftojë pranë DRAKU Tiranë, nëse do të ketë kthime nga ana e konsumatorëve.			
--	--	--	---	--	--	--

109.	30.07.2026	Kërkesë për informacion	Subjekti i interesuar kërkon informacion lidhur me: • Masat administrative të marra ndaj subjektit “R**L**” SHPK, përgjatë vitit 2025; <i>dhe</i> • Masat administrative të marra ndaj subjektit “R**L**” SHPK, përgjatë vitit 2026.	Nga verifikimet e kryera, rezulton se përgjatë vitit 2025, ndaj këtij subjekti janë kryer në total 14 (<i>katërbëdhjetë</i>) inspektive, gjatë të cilave <u>nuk është vendosur asnjë masë administrative.</u> Ndërsa, rezulton se përgjatë vitit 2026, janë kryer në total 35 (<i>tridhjetë e pesë</i>) inspektive, gjatë të cilave ndaj subjektit janë vendosur masat administrative të mëposhtme: • 5 (<i>pesë</i>) “Paralajmërimë”, për arsyet: subjekti të përditësojë regjistrat e gjurmueshmërisë dhe të marrë masa për asgjësimin e produkteve; • 20 (<i>njëzet</i>) “Gjoba” me vlerë totale prej ALL 2,000,000 (<i>dy milion lekë</i>), për arsye kryesisht mungesë gjurmueshmërie (<i>18 prej tyre</i>) dhe përgjegjësitë e operatorit (<i>2 prej tyre</i>).	04.08.2026	e plotë	nuk ka
------	------------	-------------------------	--	--	------------	---------	--------